

VENDIM
Nr. 331, datë 18.5.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 24, DATË 14.1.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE
MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT E ORGANIZIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE
TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 17, të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 89/2014, “Për pajisjet mjekësore”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 24, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) në pikën 1, fjalët “... sipas strukturës që i bashkëlidhet këtij vendimi ...” zëvendësohen me “... sipas strukturës dhe organikës, të përcaktuara në skemat 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi ...”;

b) pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5.1 Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.”;

c) shkronja “c”, e pikës 7, shfuqizohet;

ç) shkronja “dh”, e pikës 7, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh) miraton përshkrimet e punës për të gjithë punonjësit e Agjencisë.”;


d) skemat 1 dhe 2 zëvendësohen me skemat me të njëjtin numër e titull, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SKEMA.1



SKEMA 2

ORGANIKA E AGJENCISË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE

POZICIONI	NUMRI
I. DREJTOR	1
II. ZV/DREJTOR TEKNIK	1
III. ZV/DREJTOR EKONOMIK	1
IV. KOORDINATOR I RRJETIT TË KOORDINATORËVE KUNDËR KORRUPSIONIT	1
V. SEKTORI I PAJISJEVE MJEKËSORE	5
SHEF SEKTORI	1
FARMACIST/MJEK/INXHINIER	4
VI. SEKTORI I FARMAKOVIGJILENCËS	5
SHEF SEKTORI	1
FARMACIST/MJEK	4
VII. SEKTORI I AUTORIZIMIT PËR TREGTIM & ÇËSHTJEVE RREGULLATORE	12
SHEF SEKTORI	1
FARMACIST	9
MJEK	2
VIII. SEKTORI I SHPËRNDARJES SË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE	8
SHEF SEKTORI	1
FARMACIST INSPEKTOR PËR KONTROLLIN FARMACEUTIK	4
SPECIALIST	2
TEKNIK I MESËM	1
IX. SEKTORI I INSPEKTIMIT	21
SHEF SEKTORI	1
FARMACIST INSPEKTOR PËR KONTROLLIN FARMACEUTIK	16
MJEK/INXHINIER PËR PAJISJET MJEKËSORE (PËR INSPEKTIMIN E PAJISJEVE MJEKËSORE)	4
X. LABORATORI I KONTROLLIT	19
SHEF SEKTORI	1
ANALIST	14
LABORANT	4
XI. SEKTORI I INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT	4
SHEF SEKTORI	1
FARMACIST/MJEK	3
XII. SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE	6
SHEF SEKTORI	1
SPECIALIST (JURIST)	1
SPECIALIST (PËR BURIMET NJERËZORE & MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN)	1
ARKIVIST	1
PROTOKOLLIST	1
NËPUNËS INFORMACIONI	1
XIII. SEKTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE	3
SHEF SEKTORI	1
SPECIALIST (JURIST)	2
XIV. SEKTORI I FINANCËS & SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	12
SHEF SEKTORI	1

SPECIALIST (EKONOMIST)	3
MAGAZINIER	1
SHOFER	3
SANITAR	3
PUNONJËS MIRËMBAJTJEJE	1
PUNONJËS GJITHSEJ	99